

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17)

1. Nji thirrje paqi ekonomik për një paq politik	fq. 61
2. Historija e Bibliotekave në Shqipërië	„ 69
3. Konstandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut	„ 77
4. Prej folklorës së Ljarës e të Shestanit	„ 85
5. Rreth 25 vjetorit t' Indipendencës	„ 95
6. Pyjet Shqiptare	„ 102
7. Moské-Alkazar	„ 116
8. Gjendja e ujnave në Shkoder	„ 124
9. Lojët Komtare	„ 127
10. Oroena mbi një hartë të Shqipënisë	„ 132
11. Gjurmime...	„ 140
12. Mas 25 vjetsh deket të P. Luigj Paliqit	„ 145
13. Per kronikë	„ 148
14. Lajme rrokull Shqypnis	„ 151
15. Rrokull botës	„ 153
16. Bibliografi	„ 156
17. Prralla — <i>Fash.</i> 2-3.	„ 9



VJETA XIV

— Fruer-Marc 1938

— NUMRI 3-3.

Shtypshkroja Françeskane — Drejtimi: „Hylli i Dritës“ Shkoder

Nji thirrje paqi ekonomik për një paq politik

Raporta VAN ZEELAND

Raportë e shëndoshtë në parimet e saja (News Chronicle); përpjekje me zgjidhë kuadraturen e rrethit (Financjal News); polli mali... (Il Sole).

Këto e tjera si këto janë të parat gjykime mbi raportin që Z. Van Zeeland ka shkruar për një bashkëpunim ndërkombtar në sheshin ekonomik.

Z. Van Zeeland, kush s' e di, është ai burrë shteti belgas që deri dje drejtoi aqë mirë e me dobí për ekonomí e financë qeverin e vendit të vet.

Për këtë aftësi teknike të një ekonomisti e financjeri me vlerë, ëmni i tij u bënë i permendun në botën financjare ndërkombtare. U vënë në radhën e atij ëmnit zãmadh që zgon jashtë, Dr. Schacht-i i Gjermanís.

Por edhe cilsina tjera e bënë fort të çmueshëm. Në njen' anë ajo e një burri shteti të pa-ansí (Upartei) me një mendje drejtpeshuese, në tjetren urtija e tij gati mystike e një shkollë, si ajo e Louvain-it, që i ka dhënë Belgjikës burra të dijtun e të vlefshëm për atdhë e për njerzím.

Për të gjitha këto vetinë i që ngarkue me 3 prill të vjetit 1937, prej dy qeverive të mëdhá: Anglí e Francë, berra e randë me hetue e me këshillue masa për një ujdí ndërkombtare sa më të gjanë në sheshin ekonomik. Një ujdí për me rimbëkambë tregtin ndërkombtare që metoda të ndryshme e kanë bënë, mund të thomë, gati kudo të pamundëshme.

E ia ka dalë bukur e shkurt në një lëndë ku dija e

